

Megatek sh.a.
Pasqyrat Financiare
për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2020
(me Raportin e Audituesit të Pavarur bashkëlidhur)

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i - iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalet e veta	3
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare	4
Shënimet për Pasqyrat Financiare	5-34

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.


- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

16 korrik 2021



MEGATEK sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	Më 31.12.2020	Më 31.12.2019
AKTIVET			
Aktive Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	11	3,433,126,365	3,523,323,974
Aktive afatgjata jomateriale	12	29,567,542	25,980,076
Kapital aksionar i papaguar	13	200,000	200,000
Totali i aktiveve afatgjata		3,462,893,908	3,549,504,050
Aktive Afatshkurtra			
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	235,905,769	78,915,627
Parapagim i tatim fitimit	10	3,354,195	3,354,195
Inventarë	8	1,324,708,727	1,308,430,555
Llogari të arkëtueshme tregtare	6	81,226,538	160,149,527
Llogari të arkëtueshme të tjera tregtare	7	47,601,357	93,414,349
Mjete monetare në arkë e në bankë	5	228,415,136	108,627,264
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,921,211,722	1,752,891,518
Totali i Aktiveve		5,384,105,629	5,302,395,568
DETYRIME DHE KAPITALI			
Kapitalet e veta			
Kapitali aksionar i nënshkruar	21	1,519,000,000	1,519,000,000
Rezerva të tjera	21	90,804	90,804
Fitime/Humbje të mbartura	21	(408,281,631)	(461,240,579)
Fitimi i ushtrimit	21	65,293,893	52,958,946
Totali i kapitali dhe rezervave		1,176,103,066	1,110,809,171
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	20	436,722,891	565,096,480
Totali i detyrimeve afatgjata		436,722,891	565,096,480
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	14	1,200,495,502	1,092,785,858
Llogari të pagueshme tregtare	15	1,564,191,351	1,370,819,672
Hua të tjera	16	910,252,109	1,008,810,468
Detyrime tatimore	17	19,867,643	51,575,792
Llogari të pagueshme ndaj personelit	18	10,909,852	10,522,270
Detyrime të tjera	19	65,563,215	91,975,857
Totali i detyrimeve afatshkurtra		3,771,279,671	3,626,489,917
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		5,384,105,629	5,302,395,568

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 34, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u miratuan nga Drejtuesi dhe u nënshkruan si më poshtë më 23 Mars 2020 nga:

Administrator

DIONIS TEQJA

Dionis Teqja

Hartuesi

Jonida CARA / Drejtor Finance

Jonida Cara



MEGATEK sh.a.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(të gjitha vlerat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Shënime	Më 31.12.2020	Më 31.12.2019
Të ardhura nga shitja e mallrave	22	2,193,403,055	2,313,301,046
Të ardhura të tjera	23	24,618,108	154,788,528
Totali I të ardhurave		2,218,021,163	2,468,089,574
Kosto e mallrave të shitur	24	(1,338,485,637)	(1,461,024,310)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	25	(510,663,651)	(633,844,530)
Shpenzime personeli	26	(115,104,452)	(155,244,983)
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	11,12	(134,028,661)	(154,344,073)
Totali I shpenzimeve		(2,098,282,401)	(2,404,457,895)
Fitimi/(humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		119,738,762	63,631,679
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare			
Të ardhura dhe shpenzimet financiare nga interesat	27	(57,639,280)	(59,035,463)
Fitime/humbje nga kursi I këmbimit	27	16,638,609	60,219,925
Shpenzime financiare neto		(41,000,671)	1,184,461
Fitimi para tatimit		78,738,091	64,816,140
Shpenzimi I tatim fitimit	28	(13,444,197)	(11,857,195)
Fitimi për vitin financiar		65,293,894	52,958,945
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		65,293,894	52,958,945

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 33, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



MEGATEK sh.a

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
(të gjitha vlerat janë në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali Aksioner	Rezerva Ligjore & Statutore	Fitime/Humbje të pashpërndara	Fitime/Humbje të periudhes	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,519,000,000	13,590,804	(376,641,935)	51,024,491	1,206,973,360
Fitimi neto i vitit financiar				52,958,946	52,958,946
Alokimi I fitimit të pashpërndarë					-
Shpërndarja e dividendëve		(13,500,000)	(84,598,646)	(51,024,491)	(149,123,137)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,519,000,000	90,804	(461,240,581)	52,958,946	1,110,809,169
Fitimi neto i vitit financiar				65,293,896	65,293,896
Alokimi I fitimit të pashpërndarë					-
Shpërndarja e dividendëve			52,958,946	(52,958,946)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,519,000,000	90,804	(408,281,635)	65,293,896	1,176,103,065




MEGATEK sh.a.

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	Më 31.12.2020	Më 31.12.2019
Fluksi monetar gjeneruar nga / (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi/Humbja e periudhës kontabël	27,28	78,738,091	64,816,141
Rregullime për:			
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale dhe zhvlerësimi i tyre	11,12	134,028,662	154,344,073
Rimarrje e zhvlerësimit të aktiveve afatgjata materiale		9,195,204	5,152,347
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme		57,639,281	59,145,059
Shpenzime Interesi	27		
Fitimi/(Humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit përpara ndryshimeve në kapitalin punues		279,601,239	283,457,620
Ndryshime në llogaritë e arkëtueshme	6	69,727,785	43,022,443
Ndryshime në aktive të tjera të arkëtueshme	7	45,812,993	(22,440,098)
Ndryshime në inventar	8	(16,278,172)	52,363,713
Ndryshime në llogaritë e pagueshme		37,080,111	108,699,756
Ndryshime në detyrime të konstatuara		(156,990,140)	(2,894,775)
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		258,953,817	462,208,659
Interesa të paguara	27	(57,639,281)	(59,035,463)
Tatim fitimi i paguar	28	(13,444,197)	(11,857,195)
Paraja neto përdorur në veprimtaritë e shfrytëzimit		187,870,339	391,316,000
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë investuese			
Shtesa/Pakësim të aktiveve afatgjata		(47,418,519)	(30,072,033)
Rrjedha e parasë neto e përdorur në veprimtaritë investuese		(47,418,519)	(30,072,033)
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë e financimit			
(Pagesa)/Arkëtime neto nga huamarrjet nga palët e lidhura		(20,663,947)	(164,689,998)
(Pagesa)/Arkëtime neto të qirasë financiare		-	-
Dividend të paguar		-	(149,123,133)
Rrjedha e parasë neto e përdorur në veprimtaritë e financimit		(20,663,947)	(313,813,131)
Rritje neto e parave		119,787,872	47,430,837
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të periudhës		108,627,265	61,196,428
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të periudhës	5	228,415,136	108,627,265

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 34, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Megatek sh.a. është një shoqëri aksionare e regjistruar më datë 07.04.2008 me NIPT K81607050Q me seli në Tiranë, Shqipëri dhe operon në adresën Autostrada Tiranë – Durrës, Km7, Kashar. Shoqëria ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj: tregtimin me shumicë të produkteve industriale, import-eksport të produkteve industriale, prodhimin e produkteve industriale, menaxhim të hipermarketit, ushtrimin e cdo lloj aktiviteti dytësor që lidhet me ushtrimin e aktiviteteve të mësipërme, si dhe ushtrimin e aktivitetit bar-bufë dhe cdo lloj aktiviteti tjetër dytësor në mbështetje të këtij aktiviteti.

Më 31 dhjetor 2020, aksionarë të Shoqërisë janë Z. Dionis Teqja i cili zotëron 99,99 % të kuotave të kapitalit dhe Z. Apostolos Pefkos i cili zotëron 0,01 % të kuotave të kapitalit. Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është 1,519,000,000 Lek për 151,900 aksione me vlerë nominale prej 10,000 secili. Detyrat e administratorit të Shoqërisë për vitin e mbyllur ushtrimor 2020 janë ushtruar nga Z. Dionis Teqja. Shoqëria më 31 dhjetor 2020 kishte 334 punonjës (31 dhjetor 2019 kishte 322 punonjës).

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Politikat kryesore kontabël të miratuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar për të gjitha vitet e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë pasqyra financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të miratuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIFRN") të miratuara nga Komiteti i BSNK-së. Këto janë pasqyrat e para financiare të Shoqërisë të përgatitura në përputhje me SNRF-të, sipas Ligjit nr 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (shih shënimin 2.4). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të SNRF-ve për cdo klasë të pasqyrave financiare (aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet).

2.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon që aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë do të realizohen/shlyhen brenda rrjedhës normale të biznesit dhe që Shoqëria do të vijojë aktivitetin e saj operacional në të ardhmen e parashikueshme prej të paktën 12 muaj nga data e këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria përgatit buxhetet vjetore në fillim të cdo viti financiar dhe kryen në bazë të rezultateve të analizave të nevojshme për shmangiet nga vlerat buxhetore. Sipas rastit, për shkak të ndryshimeve thelbësore në Shoqëri dhe ambjentin ekonomik ku ajo operon, buxheti ndryshohet respektivisht për të reflektuar kushtet reale të tregut si dhe nevojat e Shoqërisë. Buxheti përgatitet specifikisht për zërat e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve tregtare dhe ato mbështetëse.

Bazuar dhe në analizat e likuiditetit, sipas raportit të ecures së biznesit përgatitur sipas Ligjit të Kontabilitetit, neni 13, Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vijuar aktivitetin e saj në të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se përgatitja e pasqyrave sipas parimit të vijimësisë është e përshtatshme.

2.3 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë paraqitura më poshtë.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.3 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

2.3.1 Përmbledhje e gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjeve dhe vlerësimeve

i) Kapitalizimi i shpenzimeve për software të zhvilluara nga Shoqëria

Dallimi i fazave të kërimit dhe zhvillimit të një projekti të ri software të personalizuar dhe përcaktimi nëse kërkesat e njohjes për kapitalizimin e kostove të zhvillimit janë përmbushur kërkon gjykim. Pas kapitalizimit, Drejtimi monitoron nëse kërkesat e njohjes vazhdojnë të plotësohen dhe nëse ka ndonjë tregues që kostot e kapitalizuara mund të jenë të zhvlerësuar.

ii) Zhvlerësimi i inventarit

Drejtimi mat vlerën e inventarit me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Shoqëria kryen kontrollin të vayhdueshëm të inventarit për identifikimin e artikujve të demtuar dhe atyre që u ka rënë vlera dhe kryen zhvlerësimet përkatëse. Në rast se produktet janë demtuar, ato vendosen në një sektor të veçantë të dyqanit, me një zbritje të cilën e përcakton menaxheri i dyqanit, në varësi të nivelit të dëmtimit. Kur produktet konsiderohen si jo të përdorshme dhe jashtë çdo qëllimi, ato zhvlerësohen.

iii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Shoqëria nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të miratuara nga vet Shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, si për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jofinanciare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe prezantimit. Aty ku është e aplikueshme, informacione mëtejshme në lidhje me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta janë shpalosur në shënimet specifike për atë aktivet ose detyrimet.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që vlera e drejtë e parasë dhe e parasë së ngurtësuar, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme, aktiveve të tjera afatshkurtra dhe detyrimeve të tjera afatshkurtra dhe detyrimit për tatim fitimin, përafrohet me vlerën kontabile kryesisht për shkak të maturitetit afatshkurtër të këtyre ëtave.

vi) Njohja e aktiveve tatimore të shtyra

Shkalla në të cilën mund të njihen aktivet tatimore të shtyra bazohet në një vlerësim të probabilitetit të të ardhurave të tatueshme të ardhshme të Shoqërisë kundrejt të cilit mund të përdoren aktivet tatimore të shtyra. Për më tepër, kërkohej gjykim në vlerësimin e ndikimit të çdo kufiri juridik ose ekonomik ose paqartësive në juridiksione të ndryshme tatimore.

vii) Njohja e provigjoneve për çështje ligjore

Shkalla në të cilën mund të njihet një provigjon për një çështje gjyqësore kërkon një vlerësim të ecurisë së çështjes gjyqësore dhe probabiliteteve të lidhura me fitimin ose humbjen e çështjes nga ana e Shoqërisë.

Informacioni në lidhje me vlerësimet dhe supozimet që kanë efektin më të rëndësishëm në njohjen dhe matjen e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve janë paraqitur si më poshtë. Rezultatet aktuale mund të jenë thelbësisht të ndryshme.

2.3.2 Pasiguria për çmuarjet dhe vlerësimet

i) Zhvlerësimi

Rikuperimi i aktiveve është një çështje që kërkon gjykim të Drejtimit, që kërkon vlerësim nëse vlera kontabël e aktiveve mund të mbështetet në vlerën neto aktuale të flukseve monetare të ardhshme që pritet të gjenerohen nga përdorimi i aktiveve të tilla duke përdorur parashikimet e flukseve monetare të cilat janë skontuar me një normë të përshtatshme.

ii) Inventarët

Drejtimi vlerëson në mënyrë periodike vlerat neto të realizueshme të inventarëve, duke marrë parasysh provat më të besueshme në dispozicion nga tregu. Shitja e inventarëve mund të ndikohet nga teknologjia e ardhshme ose ndryshime të tjera të ndikuara nga tregu që mund të reduktojnë më tej çmimet e shitjes.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL

- a) **Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe/ose nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por ende jo detyruesisht efektive, Standarde dhe Ndryshime në Standardet ekzistuese, dhe Interpretime janë botuar nga BSNK. Standardet dhe ndryshimet që nuk janë akoma efektive dhe nuk janë miratuar në fillim nga Shoqëria përfshijnë:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve - efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023
- Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3) - efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021
- Përkufizimi i materialitetit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8) - efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi më i hershëm.
- Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar - efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020. Lejohet aplikimi më i hershëm.

Këto standarde ose ndryshimet në standardet ekzistuese nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria. Drejtimi parashikon që të gjitha prononcimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë paraqitur pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8: Përkufizimi i materialit

Në tetor 2019, IASB lëshoi ndryshime në SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet për të lidhur përcaktimin e "materialit" përmes standardeve dhe për të sqaruar disa aspekte të përkufizimit. Përkufizimi i ri shprehet se, "Informacioni është material nëse heqja, deklarimi i gabuar ose fshehja, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të qëllimeve të përgjithshme bëjnë mbi bazën e atyre pasqyrave financiare, të cilat ofrojnë informacion financiar për një njësi specifike raportuese." Ndryshimet në përcaktimin e materialit nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Reforma e Standardit të Normës së Interesit: Ndryshime në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7

Ndryshimet në Reformën e Standardit të Normës së Interesit në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 përfshijnë një numër lehtësimesh, të cilat vlejné për të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse, të cilat preken drejtpërdrejt nga reforma e normave të interesit. Një marrëdhënie mbrojtëse ndikohet nëse reforma shkakton paqartësi në lidhje me kohën dhe ose shumën e fluksit monetar të parave të bazuara në vlerësimin e sendit të mbrojtur ose instrumentit mbrojtës. Ndryshimi është në fuqi nga 1 janar 2019. Shoqëria nuk pret një ndikim të rëndësishëm nga ky ndryshim.

Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar

Kuadri Konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar (Korniza Konceptuale) nuk është një standard, dhe asnjë prej koncepteve nuk i tejkalon ato me ndonjë standard ose ndonjë kërkesë të një standardi. IASB nxorri Kuadrin Konceptuale në Mars 2019. Ai përcakton një grup gjithëpërfshirës të koncepteve për raportimin financiar, vendosjen standarde, udhëzime për përgatitësit në zhvillimin e politikave të qëndrueshme të kontabilitetit dhe ndihmë për të tjerët në përpjekjet e tyre për të kuptuar dhe interpretuar standardet. Kuadri Konceptual përfshin disa koncepte të reja, ofron përkufizime të azhuruara dhe kritere të njohjes për aktivet dhe detyrimet dhe sqaron disa koncepte të rëndësishme. Shoqëria do të aplikoje standardet e mëposhtme kur ato të hyjnë në fuqi, por nuk pret që të ketë një ndikim në pasqyrat e saj financiare sepse këto nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (në fuqi më ose pas 1 janarit 2023)

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

- a) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe/ose nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria (vazhdim)

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (në fuqi më ose pas 1 janarit 2023) (vazhdim)

SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (d.m.th., sigurimi i jetës, jo-jetës, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe ri-sigurimi), pavarësisht nga lloji i njësive ekonomike që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiarë me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionale.

SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimit, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. Thelbi i SNRF 17 është modeli i përgjithshëm, i plotësuar nga:

- Një përshtatje specifike për kontratat me tipare të pjesëmarrjes direkte (qasja e tarifës së ndryshueshme)
- Një qasje e thjeshtuar (qasja e alokimit të primit) kryesisht për kontratat me kohëzgjatje të shkurtër

Matja e vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, duke përfshirë një rregullim të qartë të rrezikut, rimatë çdo periudhë raportuese (përmbytja e flukseve të parasë). Një Marzhë e Shërbimit Kontraktual (CSM) që është e barabartë dhe e kundërt me çdo ditë fitimi në përmbytjen e flukseve të parave të gatshme të një grupi kontratash, që përfaqëson fitimin e pafituruar të kontratave të sigurimit që do të njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së shërbimit (dmth., periudha e mbulimit). Ndryshime të caktuara në vlerën aktuale të pritshme të flukseve të ardhshme të parave rregullohen kundrejt CSM dhe në këtë mënyrë njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së mbetur të shërbimit kontraktual.

Ndryshimet në SNK 16: Prona, objektet dhe pajisjet: Të ardhurat para përdorimit të synuar, efektive më ose pas 1 janarit 2022

Ndryshimi ndalon njësitë ekonomike të zbrisin nga kostoja e një elementi të aktiveve afatgjata materiale (AAM), të gjitha të ardhurat nga shitja e artikujve të prodhuar ndërsa e sjellin atë aktiv në vendin dhe gjenden e nevojshme që ajo të jetë e aftë të veprojë në këtë mënyrë, të destinuara nga menaxhimi. Në vend të kësaj, një njësi ekonomike njihet të ardhurat nga shitja e artikujve të tillë dhe kostot e prodhimit të këtyre artikujve, në fitim ose humbje.

Ndryshimi duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive vetëm për zetat e AAM të vënë në dispozicion për përdorim në ose pas fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur kur njësia ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin.

AIP SNRF 9 Instrumentet Financiarë - Tarifat në testin e '10 përqind' për mosnjohjen e detyrimeve financiare, efektive në ose pas 1 janarit 2022

Ndryshimi sqaron tarifën që një njësi ekonomike përfshin kur vlerëson nëse kushtet e një detyrimi të ri financiar ose të modifikuar janë thelbësisht të ndryshëm nga kushtet e detyrimit origjinal financiar. Këto tarifa përfshijnë vetëm ato të paguara ose të marra ndërmjet huamarrësit dhe huadhenesit, duke përfshirë tarifën e paguara ose të marra nga huamarrësi ose huadhenesi në emër të tjetrit. Nuk ka ndonjë ndryshim të ngjashëm të ngjashëm të propozuar për SNK 39.

Një njësi ekonomike zbaton ndryshimin në detyrimet financiare që modifikohen ose shkëmbehen në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimin.

Ndryshimet në SNK 1: Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente, efektive më ose pas 1 janarit 2022

E drejta për të shtyrë shlyerjen

Nëse e drejta e një njësie ekonomike për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi i nënshtrohet njësish ekonomike në përputhje me kushtet e specifikuar, njësia ekonomike ka të drejtë të shtyjë shlyerjen e detyrimit në fund të periudhës së raportimit nëse është në përputhje me ato kushte në atë datë.

Ekzistenca në fund të periudhës raportuese

Ndryshimet sqarojnë gjithashtu se kërkesa për të drejtën për të ekzistuar në fund të periudhës së raportimit zbatohet pavarësisht nëse huadhenesi teston për pajtueshmëri në atë datë apo në një datë të mëvonshme.

Pritjet e menaxhimit

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

- a) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe/ose nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria (vazhdim)

Ndryshimet në SNK 1: Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente, efektive më ose pas 1 janarit 2022
drejta për të shtyrë shlyerjen (vazhdim)

SNK 1.75A është shtuar për të sqaruar se 'klasifikimi i një detyrimi nuk preket nga gjasat që njësisë ekonomike të ushtrorë të drejtën e saj për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit'. Kjo është, qëllimi i menaxhmentit për t'u vendosur në një periudhë afatshkurtër nuk ndikon në klasifikim. Kjo vlen edhe nëse shlyerja ka ndodhur kur pasqyrat financiare janë të autorizuar për lëshim.

Kuptimi i termit 'shlyerje'

Shlyerja me anë të instrumenteve të kapitalit të vet njësisë ekonomike konsiderohet shlyerje për qëllim të klasifikimit të detyrimeve si korente ose jo-korente, me një përjashtim. Në rastet kur një opsion shndërrimi klasifikohet si një detyrim ose pjesë e një detyrimi, transferimi i instrumenteve të kapitalit neto do të përbënte shlyerjen e pasivit me qëllim të klasifikimit të tij si aktual ose jo-aktual. Vetëm nëse vetë opsioni i konvertimit klasifikohet si një instrument i kapitalit neto, shlyerja me anë të instrumenteve të kapitalit të vet nuk do të merret parasysh kur përcaktohet nëse detyrimi është aktual ose jo rrjedhës. E pandryshuar nga standardi aktual, një qarkullim i huamarrjes konsiderohet zgjatje e një detyrimi ekzistues dhe për këtë arsye nuk konsiderohet të përfaqësojë 'shlyerje'.

Ndryshimet në SNRF 3: Përkufizimi i një biznesi, efektiv më ose pas 1 Janarit 2019.

Ndryshimet në SNRF 3: Referenca në Kuadrin Konceptual, efektive më ose pas 1 Janarit 2022.

Ndryshimet në SNK 37: Kostot e Përbushjes së Kontratës, efektive më ose pas 1 Janarit 2022

AIP SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Filiali si adoptues për herë të parë, efektiv më ose pas 1 Janarit 2022.

AIP SNK 41 Bujqësia - Taksimi në matjet e vlerës së drejtë, efektiv më ose pas 1 Janarit 2022.

Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 Shitja ose Kontributi i Aseteve ndërmjet një investitori dhe ndërmarrjes së tij të përbashkët ose ndërmarrjes së përbashkët.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

4.1 Monedha funksionale dhe raportuese

Monedha funksionale e Shoqërisë është Leku Shqiptar (LEK), e cila është monedha e përdorur në mjedisin ekonomik në të cilin Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj. Shoqëria përgatit dhe raporton pasqyrat e saj financiare në LEK. Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen fillimisht duke përdorur kursin e kembimit midis monedhës së huaj dhe monedhës funksionale në datën e kryerjes së transaksionit, që është momenti kur transaksioni kualifikohet për njohje në pasqyrat financiare. Në fund të çdo periudhë raportuese, aktivet monetare, të shprehura në monedhë të huaj, përkthehen në Lek duke përdorur kursin e këmbimit në datën raportuese. Fitimet ose humbjet që vijnë nga ndryshimet e kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivet jo-monetare mbahen me kosto historike dhe përkthehen në monedhën raportuese me kurset historike të transaksioneve.

Kurset e këmbimit të LEK-ut përkundrejt monedhave të tjera kryesore më 31 dhejtor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

Kursi i këmbimit

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
EUR/ALL	123.70	121.77
USD/ALL	100.84	108.64

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.1 Monedha funksionale dhe raportuese (vazhdim)

Kurset mesatarë të këmbimit të Lek-ut përkundrejt monedhave të tjera kryesorë për vitin 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
EUR/ALL	123.77	123.00
USD/ALL	108.53	109.85

Për aktivet monetare diferencat që rezultojnë nga konvertimi reflektohen në rezultatin e vitit. Kur diferencat rezultojnë nga zëra jomonetarë ato kalojnë në fitim ose humbje, çfarëdo diferencë e realizuar nga këmbimet valutore kalon në rezultatin e periudhës. Kur fitimi dhe humbja e zërave jomonetarë njihen në kapitalin neto, edhe diferencat nga këmbimet njihen në kapitalin neto.

4.2 Inventari

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme të tyre. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që Shoqëria pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit, duke zbritur kostot e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimeve të shitjes. Kostot e inventarit përfshijnë të gjitha kostot e blerjes dhe të tjera kosto (transport, taksa doganore, sigurimi) vetëm deri në shkallën që kryhen për ta sjellë inventarin në gjendjen dhe vendodhjen ekzistuese. Cdo zbritje tregtare e aplikuar në blerje do të zbritet në percaktimin e kostos së

blerjes së inventarit. Kosto e inventareve të perdorur nga Shoqëria dhe që nuk u shitet palëve të treta kapitalizohet si pjesë e një aktivi tjetër. Kosto e tyre njihet si shpenzim gjatë jetës së dobishme të atij aktivi.

Meqënëse metoda e identifikimit specifik është e papërshtatshme, për shkak të numrit të madh të artikujve. Shoqëria e vlerëson inventarin e saj nëpërmjet formulës së mesatares së ponderuar, formulë e cila përdoret për të gjithë artikujt e shoqërisë. Nëse, dhe për arsye të ndryshme përfshi këtu demtimin fizik, mospërdorimin, apo vjetërimin e tyre ose cmimet e shitjes kanë rënë dhe vlera neto e rikuperueshme e inventarit bie nën koston e saj, inventarët zhvlerësohen deri në nivelin e vlerës neto të realizueshme. Cmuarjet e vlerës neto të realizueshme bazohen në evidencën më të besueshme që ekziston, në kohën kur bëhen këto vlerësime, për shumën e inventarëve që pritet të realizohet. Këto cmuarje marrin në konsideratë luhatjet e cmimit, kostos që lidhet drejtpërdrejt me ngjarjet që ndodhin pas mbylljes së bilancit për sa kohë këto ngjarje konfirmojnë kushtet të cilat ekzistojnë në fund të periudhës.

Kur inventarët shiten, vlera kontabël e tyre do të njihet si shpenzim në periudhën në të cilën janë njohur të ardhurat përkatëse. Shuma e cdo zhvlerësimi inventari deri në nivelin e vlerës neto të realizueshme dhe të gjitha humbjet e inventarëve do të njihen si shpenzim të periudhës kur ndodh zhvlerësimi ose humbja. Shuma e ndonjë rimarrje të zhvlerësimit të inventarëve, që vjen nga rritja e vlerës neto të realizueshme, do të njihet si zbritje e shumës së inventarëve të njohur si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh rimarrja.

4.3 Instrumentet financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet pjesë e një marrëdhënieje kontraktuale me të tretë në lidhje me këto instrumente financiare. Aktivet financiare përbëhen nga paraja, llogari dhe kërkesa të arkëtueshme. Detyrimet financiare përfshijnë huamarrjet, llogaritë dhe detyrimet e tjera të pagueshme.

Aktivet dhe detyrimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksioneve, që janë direkt të atribuueshme në blerjen ose emetimin e ëtit financiar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare maten në vazhdim me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësim, në rastin e aktiveve financiare.

Kosto e amortizuar e një aktivi financiar ose pasivi financiar është vlera me të cilin aktivi financiar ose pasivi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizmin e akumuluar të ndonjë difference

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.3 Instrumentet financiare (vazhdim)

midis shumës fillestare dhe shumës në maturim, duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe minus çdo zvogëlim për shkak të zhvlerësimit ose pamundësisë së arkëtimit.

Metoda e interesit efektiv është një metodë llogaritje e koston së amortizuar të një aktivi financiar ose detyrimi financiar dhe e shpërndarjes e të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma që skanton rrjedhat e ardhshme të pagesave gjatë kohëzgjatjes së parashikuar të detyrimit financiar ose gjatë një periudhe më të shkurtër. Për llogaritjen e normës efektive të interesit, shoqëria duhet të cmojë të flukset monetare duke iu referuar të gjitha termave të ëtit financiar.

4.4 Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë llogari rrjedhëse bankare, para në dorë, depozita me bankat dhe të tjera mjete që janë likuide dhe ekuivalentët e tyre dhe maturiteti i tyre i mbetur nga data e raportimit nuk është më shumë se 3 muaj. Ekuivalentët e parasë janë investimet afatshkurtra, shumë likuide, të cilat janë të konvertueshme menjëherë në shumën monetare që njihen me siguri e që janë nën një rrezik minimal, përse i përket ndryshimit të vlerës. Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me koston e amortizuar.

4.5 Aktive financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për koston e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivitet financiare, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitet financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitet financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

i) Aktivet financiare me kosto të amortizuar

Aktivitet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre dhe shumica e të arkëtueshmeve të tjera që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39 bëjnë pjesë në këtë kategori të aktiveve financiare.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.5 Aktive financiare (vazhdim)

ii) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Aktivitetet financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli i biznesit, aktivitetet financiare, flukset monetare kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit kalsifikohen në kategorinë FVTPL. Të gjitha mjetet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të paracaktuara si të mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës (shih më poshtë).

Kjo kategori gjithashtu përmban një investimet në kapital. Aktivitetet në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Sipas kërkesave të SNRF 9 nuk lejohet mbajtja me kosto e këtyre aktiveve.

Shoqëria më 31 dhjetor 2020 nuk ka aktive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes.

iii) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Shoqëria llogarit aktivitetet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse FVOCI nëse aktivitetet plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektiv i të cilit është "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" dhe
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas rregjistrimit të aktivitetit. Rënia në vlerë i aktiveve financiare, individualisht të rëndësishme, vlerësohet veçmas për secilin aktiv. Aktivitetet financiare, të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht dhe për të cilat nuk ka të dhëna mbi përkeqësimin e tyre, vlerësohen në mënyrë kolektive për ndonjë rënie në vlerën e tyre.

Nëse në periudhat e mëpasme, shumat e humbjeve nga rënia në vlerë i aktivitetit financiar të matur me koston e amortizuar uljet dhe kjo ulje vjen për shkak të një ngjarjeje pasi është njohur përkeqësimi, humbja nga përkeqësimi e njohur më parë stornohet deri në shumën më të vogël midis vlerës së re të rikuperueshme dhe vlerës kontabël të matur me koston e amortizuar, nëse nuk do të ishte konstatuar humbja nga përkeqësimi i aktivitetit. Anullimi i humbjes pasqyrohet në të ardhurat. Një aktiv financiar ç'regjistrohet kur Shoqëria humbet të drejtën mbi flukset e parave të aktivitetit financiar ose transferon flukset e parave që vijnë nga aktiviteti financiar, si dhe shumicën e rreziqeve dhe të mirave që lidhen me zotërimin e aktivitetit financiar të një palë e tretë. Me ç'regjistrimin e një aktiviteti financiar, diferenca mes vlerës kontabël të aktivitetit financiar dhe shumës së arkëtuar për të njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e fitime humbjeve.

4.6 Detyrime financiare

Detyrimet financiare përfaqësojnë llogaritë të pagueshme dhe të tjera, kredi dhe hua të tjera nga institucione financiare dhe të tretët. Instrumentat financiarë klasifikohen si detyrime financiare në përputhje me bazën e marrëveshjeve kontraktuale dhe përcaktimet e një detyrimi financiar. Llogaritë e pagueshme tregëtare dhe të tjera, fillimisht njihen me vlerën e drejtë të shumës për t'u paguar sipas kontratës përkatëse, dhe me pas maten me koston e amortizuar duke përdorur normën efektive të interesit. Huatë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksionit të ndodhura dhe më pas maten me koston e amortizuar, duke përdorur normën efektive të interesit. Një detyrim financiar nuk njihet, kur ai shlyhet, anulohet ose skadon. Një detyrim financiar shlyhet kur ai paguhet ose i kalohet në mënyrë kontraktuale një palë tjetër. Një detyrim financiar anulohet, nëse pala tjetër e ka anuluar atë. Pas ç'regjistrimit të një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël të detyrimit dhe shumës së paguar për të njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.7 Aktive afatgjata materiale

4.7.1 Njohja

Aktivet afatgjata materiale paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Aktivet Aktivet afatgjata materiale njihen nëse dhe vetëm nëse është e mundur që Shoqëria në të ardhmen të ketë përfitime ekonomike nga ky aktiv dhe kostot e krijimit të mund të maten me besueshmëri. Kosto përfshin koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Shoqërisë. Elementë të tillë si: pjesë këmbimi, pajisje dhe makineri ndihmëse njihen si aktiv afatgjatë material kur plotësojnë kriterin për kapitalizim nga Shoqëria. Në rast të kundërt ato njihen dhe trajtohen si inventarë dhe njihen si fitim ose humbje kur konsumohen. Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme dhe kostot e zëvendësimit të një elementi të aktiveve afatgjata materiale, i shtohen kostos së aktiveve afatgjata materiale vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe kriteret për njohjen e aktiveve në bilanc (duke përfshirë këtu aftësinë e tyre për të marrë pjesë në gjenerimin e përfitimeve të ardhshme ekonomike). Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë periudhës. Nëse kriteret për njohje të aktivit plotësohen, kostot që lindin me vonë për të shtuar, zëvendësuar ose riparuar aktivin afatgjatë material i shtohen vlerës së mbetur të aktivit. Nëse kriteret për njohje nuk përmbushen, atëherë këto kosto do të jenë shpenzime të periudhës në të cilën ndodhin.

4.7.2 Matja pas njohjes

Kur një element i aktiveve afatgjata materiale kualifikohet për t'u njohur si një aktiv, fillimisht matet me koston e tij dhe paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Ne rastin e një aktivit të blerë, kosto përfshin cmimin e blerjes bashkë me tarifat doganore dhe taksa të tjera të parimbursueshme, zbritjet në fakturë dhe rabate, kostot e transportit, kostot e instalimit dhe cdo kosto tjetër që kryhet

4.7.2 Matja pas njohjes (Vazhdim)

për ta sjellë aktivin në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Shoqërisë. Per aktive te ndertuara vete, kostot perfshijnë materiale direkte të përdorura, koston e punës së punëtorëve dhe kosto të cilat janë direkt të lidhura me ndërtimin e aktivit si dhe kosto financiare të kredimarrjeve për ndërtimin e aktivit. Cdo fitim i brendshëm i krijuar gjatë këtij procesi eliminohet në përcaktimin e kostos së aktivit.

Shtimi i kostove në vlerën e mbetur të një elementi të aktiveve afatgjata materiale ndalon kur aktiviteti vihet në vendndodhjen dhe është në gjendjen e duhur për t'u vënë në punë. Normat e amortizimit në përqindje të aktiveve afatgjata materiale për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Ndërtesa	5%	5%
Instalime teknike dhe makineri	20%	20%
Mjete transporti	20%	20%
Paisje zyre	20%	20%
Paisje informatike	25%	25%
Ndërtesa	5%	5%

Amortizimi llogaritet mbi bazën e vlerës së mbetur për secilën prej kategorive të mësipërme, pa tejkaluar kufirin maksimal të përcaktuar në ligjin mbi tatimin mbi të ardhurat. Ndërkohë amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale, llogaritet sipas metodës lineare në masën 15 %. Zhvlerësimi përllogaritet mbi vlerën e mbetur të aktivitetit dhe toka nuk zhvlerësohet.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.8 Aktive afatgjata jomateriale

4.8.1 Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata jomateriale me një jetëgjatësi të paracaktuar mbahen me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Amortizimi njihet si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas metodës lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese duke konsideruar çfarëdo lloj ndryshimi dhe efektet e saj si ndryshim në vleresimet kontabël dhe duke e aplikuar për periudhat e ardhshme. Aktivët afatgjata jomateriale me një jetëgjatësi të paracaktuar mbahen me kosto duke i zbritur humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

4.9 Rënia në vlerë e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale

Shoqëria rishikon vlerën e mbetur të aktiveve të saj materiale dhe jomateriale për të evidentuar rrethana që do të sillnin rënie në vlerën e tyre. Për të paracaktuar nëse një aktiv mund të ketë rënie në vlerë, kryhet një test, nëpërmjet të cilit vlerësohet shuma e rikuperueshme. Një test rënieje në vlerë kryhet për aktivet që tregojnë shenja të rënies në vlerë. Testi i rënies në vlerë kryhet me qëllim që të paracaktohet shuma e rikuperueshme e një aktivi afatgjatë, e cila është shuma më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivi afatgjatë (minus koston e shitjes) dhe vlerës në përdorim të tij. Nëse indikatorë të tillë ekzistojnë, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit për të evidentuar sipas rastit humbjet nga rënia në vlerë.

Nëse shuma e rikuperueshme e aktivit rezulton të jetë më e vogël se vlera e mbetur, atëherë kjo e fundit zvogëlohet deri në vlerën e rikuperueshme të aktivit. Humbja nga rënia në vlerë njihet direkt në rezultatin e vitit përvec rasteve kur aktiv i është mbajtur me vlerën e rivlerësuar. Në këtë rast humbja nga rënia në vlerë do të njihej si ulje e rezervës së rivlerësimit të krijuar më parë. Nëse ka shenja që shuma e rikuperueshme e një aktivi afatgjatë është rritur mbi vlerën kontabël, humbja e mëparshme nga rënia në vlerë rimerret dhe vlera kontabël e aktivit rritet. Kufiri më i lartë i rritjes është vlera e mëparshme kontabël e aktivit afatgjatë minus amortizimin gjatë viteve të ndërmjetme. Rimarrja e një humbjeje nga rënia në vlerë për një aktiv afatgjatë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën raportuese, si një pakësim i humbjes nga rënia në vlerë i aktiveve afatgjata.

4.10 Të ardhurat

Të ardhurat konsiderohen hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat lindin si pasojë e veprimtarisë së zakonshme të Shoqërisë. Të ardhurat përfshijnë elemente të tillë si shitja mallrave, tarifa shërbimi, interesa dhe qira që maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e zbritjeve të ofruara për volumin e shitur, siç specifikohet në kontratë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur: (i) Shoqëria i ka transferuar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitime të konsiderueshme në lidhje me pronësinë e mallrave; (ii) Shoqëria nuk mban asnjë të drejtë dhe nuk është e përfshirë në administrimin e mallrave sic ndodh kur ka pronësinë; (iii) vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; (iv) është e mundur që Shoqëria do të marrë përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin dhe kostot e ndodhura ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

i) Njohja e të ardhurave nga shitja

Përcaktimi se kur dhe në ç'masë duhet të njihen të ardhurat nga shitjet, kërkon një kuptueshmëri mbi llojin e transaksionit dhe shërbimeve të tjera të përfshira në shitjen e mallrave

• *Identifikimi i kontratave me klientët*

Shoqëria është e angazhuar në shitjen e mallrave sipas kontratave me klientët, sipas kërkesave të tyre dhe gjendjes së mallrave për rishitje. Kontratat me klientet janë zakonisht të nënshkruara në të cilat specifikohen produktet dhe cmimet përkatëse. Shitjet në hipermarket, nuk janë të rregulluara me anë të kontratave, por përfaqësojnë një detyrim të Shoqërisë për të furnizuar blerësit me mallrat që ata kanë zgjedhur.

• *Identifikimi i detyrimeve të performancës*

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.10 Të ardhurat (vazhdim)

Përcaktimi i detyrimeve të performancës varet nga mënyra e kryerjes së transaksionit të shitjes. Për shitjet në hipermarket, detyrimet e performancës kufizohen tek mallrat e rishitjes, kontrolli i të cilave transferohet tek klienti në momentin e shitjes. Ndërsa shitjet e-commerce ose/dhe me kontratë, detyrimi i performancës përfshin shërbimet përkatëse të transportit, montimit ose instalimit.

• *Përcaktimi i cmimit të transaksionit*

Cmimi i transaksionit përcaktohet si totali i cmimeve të çdo komponenti të detyrimit të performancës.

• *Shpërndarja e cmimit të transaksionit për çdo detyrim të performancës*

Në rastet kur transaksioni i shitjes, pëfshin dhe shërbimet e montimit, instalimit ose transportit, cmimi i transaksionit do të shpërndahet mbi komponentët e detyrimeve të performancës, duke i cilësuar si një component i vetëm. Në transaksionet kur kontrolli i mallrave kalon menjëherë tek blerësi, cmimi i transaksionit do të përfshijë vetëm cmimin e mallit të shitur.

• *Natyra dhe koha e përmbushjes së kushteve të performancës*

Për shitjet në hipermarket, të ardhurat do të njihen në momentin kur ato ndodhin, që përkon me transferimin e kontrollit të mallit tek klienti, ndërsa për produktet "on-delivery", të ardhurat do të njihen në momentin kur produkti transportohet, montohet dhe/ose instalohet tek klienti. Shoqëria nuk ofron shërbime të tjera të cilat zgjasin më shumë në kohë, për të cilat të ardhurat do të njiheshin sipas realizimit të shërbimit.

4.11 Shpenzime huamarrjeje

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë e marra. Kostot e huasë njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet në banka. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit prezantohen neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi të lëvizjes në kursin e këmbimit nëse rezultojnë në një pozicion neto fitimi apo humbje.

4.12 Tatim fitimi

Shpenzimi për tatim fitimin përfaqëson shumën e tatim në fitimin ose humbjen e periudhës. Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet ose të rikuperohet në lidhje me fitimin e tatueshëm të periudhës, duke përdorur normën tatimore në fuqi, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Shpenzimi i vitit për tatim fitimin përlllogaritet duke përdorur normën e tatim fitimit e cila është e aplikueshme në fund të periudhës raportuese. Shpenzimi për tatim fitimin është njohur në rezultatin e vitit.

4.13 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore vetëm në skemen e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të administruar nga Insituti i Sigurimeve shoqërore sic përkactohet në ligj. Kontributet njihen si shpenzime për përfitimet e punonjësve. Shoqëria nuk ka detyrime të mëtejshme ndaj punonjësve të saj përtej këtyre kontributeve.

4.14 Provizionet

Një provision njihet nëse, si rezultat i ngjarje të shkuar, shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri dhe është e mundur një dalje të përfitimeve ekonomike të kërkohej për të shlyer detyrimin.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

4.15 Informacioni krahasues

Të dhënat krahasuese janë riklasifikuar kur ka qenë e nevojshme, në përputhje me ndryshimet në prezantimin në periudhën aktuale. Megjithatë, këto riklasifikime nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme të përmbytjes dhe paraqitjen e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

5. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTËT E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Gjendja në banka	214,052,004	93,450,187
Lekë (i)	192,891,121	49,564,378
Monedhë e huaj (ii)	21,160,883	43,885,809
Gjendja në arka	14,363,133	15,177,078
Lekë (iv)	13,473,779	14,155,803
Monedhë e huaj (v)	889,354	1,021,275
TOTALI	228,415,136	108,627,265

Gjendjet në banka përbëhen nga llogari rrjedhëse në vlerë të emërtuara në monedhën vendase dhe të huaj, përkatësisht në Euro dhe Dollarë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, ndërsa gjendjet në arka janë të emërtuara në Lek, Euro dhe Dollarë, ku monedha kryesore Euro dhe Dollarë kanë një vlerë prej 889,354 Lek (2019: 1,021,275 Lek).

Shoqëria operon nëpërmjet llogarive bankare në banka të nivelit të dytë rezidente në Shqipëri, të paraqitura si më poshtë së bashku me vlerësimin përkatës:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Alpha Bank	137,124,893	58,972,348
Banka Kombetare Tregtare	27,127,530	10,648,417
Credins Bank	710,649	5,284,063
Banka Amerikane e Investimeve	4,402,784	568,663
OTP	4,679,040	1,488,034
Raiffeisen Bank	3,850,761	2,266,905
Tirana Bank	36,156,346	14,221,755
TOTALI	214,052,004	93,450,187

6. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme nga aktiviteti tregtar më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Me palë të treta	58,699,035	57,640,204
Me palë të lidhura	43,318,073	114,104,690
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(20,790,571)	(11,595,367)
TOTALI	81,226,538	160,149,527

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

6. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE (VAZHDIM)

Shoqëria hyn në marrdhënie tregtare me individë dhe subjekte, përfshirë palët e lidhura, për shitjen e mallrave me arkëtim të mëvonshëm, pa aplikuar skonto për arkëtimet më të hershme ose penalitet për llogaritë e vjetëruara. Të arkëtueshme tregtare deri në 365 ditë maturim më 31 dhjetor 2020 janë 63,024,588 Lek (2019: 136,132,850 Lek). Shoqëria monitoron llogaritë e arkëtueshme tregtare për vlerën e tyre të rikuperueshme dhe ka njohur një rritje prej 9,152,206 Lek të fondit të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve tregtare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 (2019: (5,152,347 Lek).

7. LLOGARI TË ARKËTUESHME TË TJERA

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2020
Ngurtësime - garanci bankare	21,816,083	68,622,821
Të arkëtueshme nga DPD	12,569,647	12,569,647
Të arkëtueshme nga DGT llogaria operacionale	1,561,524	2,201,672
Të arkëtueshme nga personeli etj	5,670,322	3,843,400
Të arkëtueshme nga Megatek Albania sh.p.k.	4,010,947	6,098,500
Taksa dhe shpenzime gjyqësore për tu arkëtuar	1,972,834	78,310
Interesa Per tu arkëtuar nga Banka	-	-
TOTALI	47,601,357	93,414,349

Gjendjet në banka në formë ngurtësimesh me një vlerë prej 21,816,083 më 31 dhjetor 2020 (2019: 68,622,821 Lek) janë garanci bankare lëshuar në favor të (i) Institucioneve Doganore në Shumën 14,000,000 lekë (ii) Institucioneve Tatimore në Shumën 7,000,000 lekë dhe (iii) Në favor të furnitorëve të ndryshëm ose për pjesmarrje në tender në shumën prej 816,083 Lek (2019: 47,622,821 Lek). Garancitë bankare maturohen brenda tri muajve nga data e raportimit dhe janë rinovuar për të paktën një vit nga maturimi i tyre.

Të arkëtueshme nga DPD (Drejtorja e përgjithshme e Doganave) përbëhet nga një pagesë për garanci ligjore pranë DPD, ndërsa të arkëtueshme nga DGT (Drejtorja e Doganës së Tiranës) është e lidhur me llogarinë operacionale e cila përfaqëson shumën e parapaguar ose paguar mbi vlerën e detyrimit ndaj DPD për zhdoganimet e mallrave.

Të arkëtueshme në vlerën 4,010,947 i referohet një huaje dhënë shoqërisë Megatek sh.p.k. në Kosovë e cila është në pronësi të aksionarit të shumicës, z. Dionis Teqja. Kredia është pa interes dhe e pakolateralizuar me një afat maturimi 6 mujor dhe e rinovueshme në mbarim të afatit të maturimit.

8. INVENTAR

Inventari më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Gjendje më 1 Janar	1,308,430,555	1,360,794,268
Zhvlerësimi nga shkatërrimi i inventarit	-	(36,017,958)
Zhvlerësimi nga inspektimi fizik i inventarit	(4,309,071)	(3,274,530)
Ndryshim i gjendjes së inventarit	20,587,242	(13,071,225)
Gjendje më 31 dhjetor	1,324,708,727	1,308,430,555

Shoqëria ka kryer gjithashtu inspektimin fizik të inventarit në mënyrë periodike gjatë vitit ushtrimor si dhe të organizuar në periudhën janar – mars 2021, me qëllim verifikimin e sasisë fizike të inventarit dhe kushteve të inventarit për rishitje. Cdo njësi inventari në mungesë ose/dhe cdo inventar që nuk plotëson kushtet për rishitje, është zhvlerësuar me koston përkatëse dhe është c'regjistruar nga kontabiliteti me vlerën kontabël. Inventari përfshin rreth 60 mijë artikuj më 31 dhjetor 2020 të ndarë sipas kategorive përkatëse. Klasat e inventarit të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë shpërndarë si më poshtë:

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. INVENTAR (VAZHDIM)

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Mallra, artikuj Automjete	8,082,853	11,289,428
Mallra, artikuj Elektrike	63,779,358	34,446,043
Mallra, artikuj Kancelari	16,550,344	11,250,115
Mallra, artikuj Kopshtarie	116,168,431	121,698,252
Mallra, artikuj Kujdesi i Kafshëve	2,785,379	1,898,113
Mallra, artikuj Mjete ngrohëse dhe ftohëse	36,922,508	25,539,570
Mallra, artikuj Ndërtimi	512,745,246	509,640,269
Mallra, artikuj Orendi paisje të brendshme	447,991,766	506,286,307
Mallra, artikuj të tjerë	17,273,812	336,984
Mallra, artikuj vegla pune	76,148,645	86,045,474
Mallra, artikuj Ushqime & Pije	7,707,416	-
Mallra, artikuj Farmaci	18,548,510	-
Mallra, artikuj Veshje dhe mode	4,458	-
Gjendje më 31 dhjetor	1,324,708,727	1,308,430,555

9. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagime dhe shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Parapagime per furnitore	232,380,985	73,920,363
Shpenzime te shtyra, bileta avioni	1,350,252	2,838,576
Shpenzime te shtyra: sigurim prona	1,862,312	1,929,984
Shpenzime te shtyra: prim sigurimi.	312,220	226,704
TOTALI	235,905,769	78,915,627

Parapagimet për furnitorë përfshijnë parapagime për mallra dhe shërbime të nevojshme për kryerjen e aktivitetit tregtar. Më 01 janar 2018 (data e adoptimit për herë të parë i SNRF-ve), zëri parapagime për furnitorë është riklasifikuar në pasqyrën e pozicionit financiar si aktiv në "Parapagime dhe shpenzime të shtyra" kundrejt klasifikimit në zërin llogari tregtare të pagueshme deri më 31 dhjetor 2017 sipas SKK-ve.

Shpenzime të tjera të shtyra përfshijnë bileta avioni të blera paraprakisht të cilat te cilat si pasojë e situates se pandemise jane shtyre per tu shpenzuar ne vitin 2021, ndërsa shpenzimet e sigurimit përfshijnë sigurimin e aktiveve afatgjata materiale si dhe inventari për rishitje, të cilat amortizohen në bazë mujore.

10. PARAPAGIMI I TATIM FITIMIT

Parapagimi i Tatim fitimit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si në vijim:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Tatim fitimi i parapaguar	3,354,195	3,354,195
TOTALI	3,354,195	3,354,195

Parapagimi i tatim fitimit prej 3,354,195 Lek, përfaqëson tepricën kreditore të tatim fitimit në vitin ushtrimor 2017, e cila rezulton në sistemin tatimor se është përdorur (kompesuar automatikisht) për gjoba dhe kamatvonesa të vitit ushtrimor 2014). Këto detyrime janë aktualisht në proces apelimi pas përfundimit të trajtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe në përfundim të procesit gjyqësor, do të vepohet në përputhje me vendimin e gjykatës.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Kosto	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe paisje	Mjete transporti	Mobilje	Te tjera	Totali
Më 31 dhjetor 2018	1,500,000,000	2,577,956,446	150,846,232	47,116,376	187,968,056	16,202,700	4,480,085,810
Shtesa		7,121,415	7,663,162	4,520,712	276,319	6,428,647	26,010,255
Pakësime			(1,939,060)	-	(10,497)	(14,354)	(1,963,911)
Më 31 dhjetor 2019	1,500,000,000	2,585,077,861	156,570,334	51,637,088	188,233,878	22,616,993	4,504,136,154
Shtesa	-	-	11,496,178	743,637	14,084,723	12,290,090	38,614,629
Pakësime	-	-	(696,800)				(696,800)
Më 31 dhjetor 2020	1,500,000,000	2,585,077,861	167,369,712	52,380,725	202,318,601	34,907,083	4,542,053,981

Amortizimi I akumuluar	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe paisje	Mjete transporti	Mobilje	Te tjera	Totali
Më 31 dhjetor 2018	-	(594,941,876)	(91,503,987)	(26,470,115)	(117,027,889)	(4,144,719)	(834,088,586)
Pakësime	-	-	1,624,328	-	8,148	9,985	1,642,461
Shtesa	-	(112,586,663)	(14,213,825)	(4,284,362)	(14,265,596)	(3,015,609)	(148,366,055)
Më 31 dhjetor 2019	-	(707,528,539)	(104,093,484)	(30,754,477)	(131,285,337)	(7,150,343)	(980,812,180)
Pakësime	-	-	552,672				552,672
Shtesa	-	(95,091,652)	(6,236,478)	(4,254,681)	(12,229,083)	(10,856,213)	(128,668,109)
Më 31 dhjetor 2020	-	(802,620,191)	(109,777,290)	(35,009,158)	(143,514,420)	(18,006,557)	(1,108,927,617)

Vlera kontabël neto	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe paisje	Mjete transporti	Mobilje	Te tjera	Totali
Më 31 dhjetor 2018	1,500,000,000	1,983,014,570	59,342,245	20,646,261	70,940,167	12,057,981	3,646,001,224
Më 31 dhjetor 2019	1,500,000,000	1,877,549,322	52,476,850	20,882,611	56,948,541	15,466,650	3,523,323,974
Më 31 dhjetor 2020	1,500,000,000	1,782,457,670	57,592,422	17,371,566	58,804,181	16,900,526	3,433,126,365

Toka dhe ndërtesa me një vlerë të mbetur më datë 31 dhjetor 2020 prej 3,282,457,670 Lek (2019: 3,377,549,322 Lek) janë vendosur si kolateral për kredinë afatgjatë të përfunduar nga dy banka të nivelit të dytë.




MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

12. AKTIVE AFATGJATA JO MATERIALE

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si më poshtë:

Kosto	Programë kompjuteri dhe Licenca	Programë Informatike	Aktive të tjera materiale	Totali
Më 31 dhjetor 2018	-	69,964,956	6,969,003	76,933,959
Shtesa	328,779	3,528,488	541,171	4,398,438
Pakësime		(15,210)		(15,210)
Më 31 dhjetor 2019	328,779	73,478,234	7,510,174	81,317,187
Shtesa		8,948,020		8,948,020
Pakësime				-
Më 31 dhjetor 2020	328,779	82,426,254	7,510,174	90,265,207

Amortizimi i akumuluar	Programë kompjuteri dhe Licenca	Programë Informatike	Aktive të tjera materiale	Totali
Më 31 dhjetor 2018	-	(46,076,986)	(3,282,107)	(49,359,093)
Pakësime				-
Shtesa		(5,366,427)	(611,591)	(5,978,018)
Më 31 dhjetor 2019	-	(51,443,413)	(3,893,698)	(55,337,111)
Pakësime				-
Shtesa		(5,015,426)	(345,128)	(5,360,554)
Më 31 dhjetor 2020	-	(56,458,839)	(4,238,826)	(60,697,665)

Vlera kontabël neto	Programë kompjuteri dhe Licenca	Programë Informatike	Aktive të tjera materiale	Totali
Më 31 dhjetor 2018	-	23,887,970	3,686,896	27,574,866
Më 31 dhjetor 2019	328,779	22,034,821	3,616,476	25,980,076
Më 31 dhjetor 2020	328,779	25,967,415	3,271,348	29,567,542

Aktivët afatgjata jo materiale përbëhen nga sisteme dhe programe kompjuterike, aplikacione në zhvillim, web-site, licenca etj. aktive të cilat kanë jetë të dobishme të përcaktuar dhe amortizohen sipas metodës lineare. Shtesa prej 328,779 Lek në vitin 2019 i referohet shpenzimeve të zhvillimit të aplikacionit për inspektimin fizik të inventarit të cilat nuk amortizohen derisa aktivi të jetë në kushte përdorimi.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

13. KAPITALI AKSIONAR I PAPAPAGUAR

Kapitali aksionar i papaguar më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është i përbërë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Kapital aksionar i papaguar	200,000	200,000
TOTALI	200,000	200,000

Kapitali aksionar i papaguar pasqyron vlerën e papaguar të aksioneve të aksionarit Apostolos Pefkos. Shih shënimin 21 për detaje mbi numrin dhe cmimin e aksioneve të aksionarit.

14. HUA AFATSHKURTRA

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë vijon:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Overdraft	1,063,161,865	1,009,617,386
Hua afatgjatë e pagueshme brenda 1 viti	137,333,637	83,168,472
Hua bankare afatmese	-	-
TOTALI	1,200,495,502	1,092,785,858

Shoqëria ka marrë një overdraft nga dy banka të nivelit të dytë sipas kontratave të ndryshuara në vitin 2017 për financimin e nevojave të biznesit, për të cilën Shoqëria ka vendosur si kolateral inventar gjendje për rishitje në vlerën 5,5 milion Euro. Overdrafti është i emërtuar në Euro me një normë interesi prej rreth 3%.

Huaja e pagueshme brenda 1 viti i referohet pjesës së huasë afatgjatë e cila do të paguhet brenda një periudhe prej 12 muaj nga data e raportimit financiar, së bashku me interesin e përllogaritur nga data më e fundit e këstit deri më 31 dhjetor 2020. Interesi është përllogaritur mbi bazë ditore sipas normave nga 2-4% të interesit të kredisë. Shih shënimin 20 për detaje mbi huanë afatgjatë.

15. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Të pagueshme ndaj palëve të treta	1,564,191,351	1,370,819,672
TOTALI	1,564,191,351	1,370,819,672

Llogaritë e pagueshme tregtare i referohen të pagueshmeve ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, blerjen e aktiveve fikse dhe burimeve të tjera të nevojshme për kryerjen e aktivitetit tregtar. Shoqëria hyn në marrdhënie tregtare me furnitorë vendas dhe të huaj për blerjen e mallrave për rishitje, ndaj është subjekt i procedurave të zhdoganimit për rastin e importeve. Për llogaritë e pagueshme nuk janë aplikuar skonto për shlyerje më të hershme apo penalitete për llogari të vjetëruara.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

16. HUA TË TJERA

Hua të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Hua nga shoqëri në pronësi të aksionarit të shumicës	910,252,109	1,008,810,468
TOTALI	910,252,109	1,008,810,468

Hua të tjera përbëhen nga hua të përfutuara nga shoqëritë e klasifikuara si palë të lidhura, kryesisht nga shoqëri në pronësi të aksionarit të shumicës. Për keto hua Shoqëria, ka nënshkruar marrëdhënie kontraktuale të financimit pa interes dhe me një afat maturimi të papërcaktuar. Kreditë e narra nga Shoqëritë në pronësi të aksionarit të shumicës janë kryesisht në Lek dhe të pakolateralizuara (shih shënimin 30), respektivisht nga Teqja International sh.a. Global Construction sh.a. dhe Spartan Security sh.p.k. më 31 dhjetor 2020.

17. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Detyrime për TVSH	13,763,891	46,483,937
Detyrime për Sigurime shoqërore, shëndetësore dhe TAP	3,970,707	3,835,483
Detyrime për Tatim në burim	248,437	60,142
Detyrim për tatimin mbi fitimin	1,884,607	1,196,230
TOTALI	19,867,643	51,575,792

Detyrimet tatimore përfaqësojnë detyrimet ndaj organeve tatimore të papaguara në datën e raportimit për tatimin mbi vlerën e shtuar, sigurime shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimin mbi të ardhurat personale për llogari të personelit, tatimin në burim për konsultët ose ekspertët e kontraktuar të Shoqërisë si dhe tatim fitimin. Detyrimet tatimore janë paguar në janar 2021.

18. LOGARI TË PAGUESHME NDAJ PERSONELIT

Llogaritë e pagueshme ndaj personelit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë vijon:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Paga të pagueshme ndaj personelit	10,909,852	10,522,270
TOTALI	10,909,852	10,522,270

Të pagueshmet ndaj personelit paraqesin detyrimet e Shoqërisë ndaj punonjësve me kohë të plotë për pagat neto të muajit dhjetor 2020. Shoqëria nuk aplikon bonuse për shitjet e mallrave të hipermarketit si dhe nuk ka njohur dhe shpërndarë bonus për performancën për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

19. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA

Llogaritë e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë vijon:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Parapagime të marra nga klientë	1,213,450	695,006
Detyrime Taksa Doganore në pritje për tu paguar	42,635,050	30,573,684
Dividend për tu paguar	20,324,701	53,942,703
Detyrime të tjera	1,390,014	6,764,464
TOTALI	65,563,215	91,975,857

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

19. LLOGARI TË PAGUESHME TË TJERA (VAZHDIM)

Detyrimet të tjera përbëhen nga detyrimet për parapagimet e marra nga klientët si rezultat i marrdhënieve tregtare, detyrimet për taksa doganore dhe të tjera të ngjashme për mallrat e blerë të cilat më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë gjendje në magazinën doganore. Detyrimet për dividendë i referohen pjesës së papaguar të dividendëve.

20. HUA AFATGJATA

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Hua Bankare Afatgjatë	436,722,891	565,096,480
TOTALI	436,722,891	565,096,480

Huaja afatgjatë i referohet pjesës së huasë e cila do të paguhet për një periudhë më të gjatë se 12 muaj nga data e raportimit financiar. Shoqëria ka marrë nga dy banka të nivelit të dytë një kredi të përbashkët, si ristrukturim i kredisë së hershme të përfutur në vitin 2008. Kredia e ristrukturuar është disbursuar në monedhën Euro në vitin 2017 me një maturim 5 vjeçar deri në qershor 2022. Si rezultat i pandemisë, Shoqëria ka përfutur një shtyrje të pagesës së principalit të muajit qershor 2020 prej 284 mijë Euro deri në maturimin e kredisë në vitin 2022.

21. KAPITALET E VETA

Kapitali më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë vijon:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Kapitali aksionar i nënshkruar	1,519,000,000	1,519,000,000
Rezerva ligjore	90,804	90,804
Rezerva statutore	-	-
Fitime/Humbje të mbartura	(408,281,631)	(461,240,579)
Fitimi/humbja e vitit ushtrimor	65,293,893	52,958,946
TOTALI	1,176,103,066	1,110,809,171

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, aksionarë të Shoqërisë janë Z. Dionis Teqja i cili zotëron 99,99 % të kuotave të kapitalit dhe Z. Apostolos Pefkos i cili zotëron 0,01% të kuotave të kapitalit. Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është 1,519,000,000 LEK me 151,900 aksione me vlerë nominale prej 10,000 LEK secili, ndërsa kapitali i papaguar është 200,000 Lek.

22. TË ARDHURAT NGA SHITJA

Të ardhurat nga aktiviteti tregtar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 të paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shitja e mallrave	2,193,922,965	2,313,683,067
Zbritjet financiare për klientet	(519,911)	(382,020)
TOTALI	2,193,403,055	2,313,301,047

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

22. TË ARDHURAT NGA SHITJA (VAZHDIM)

Gjatë vitit 2020, Shoqëria ka shtuar si aktivitet tregtar shitjet online të mallrave në Shqipëri e Kosovë, transporti i të cilave kryhet nga kontraktorët e Shoqërisë. Pjesë e të ardhurave nga shitjet online janë dhe shërbimet e transportit, montimit dhe instalimit në varësi të llojit të produktit, cmimi i të cilave përcaktohen në mënyrë të pavarur nga cmimi i produktit, në varësi të distancës së transportit dhe kostos së nevojshme për montim/instalim etj.

Shoqëria aplikon gjithashtu zbritje në cmimin e shitjes për mallrat në bazë të ofertave promocionale ose eventeve në Megatek. Zbritjet tregtare përlogariten automatikisht për çdo produkt të faturuar sipas listës së cmimeve të miratuar paraprakisht.

Me përjashtim të shitjeve të lartpërmendura, Shoqëria nuk është e angazhuar në forma të tjera të gjenerimit të të ardhurave nga aktiviteti tregtar, që do të kërkonin prezantim të vecantë në shënimet shpjeguese.

23. TË ARDHURAT E TJERA

Të ardhurat të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shitja e AAM	5,197,101	131,494,979
Të ardhura nga qiratë	18,557,926	21,433,358
Të ardhura të tjera rrjedhëse	863,080	1,860,191
TOTALI	24,618,108	154,788,528

Të ardhurat të tjera janë të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit, si shitja e aktiveve afatgjata materiale, të ardhura nga ambjentet e dhëna me qira, të ardhura nga shitjet në ambjentin e bar-it në hipermarket, të ardhura nga banerat e vendosur në zonën e ndërtimit dhe të parkimit si dhe të ardhura të tjera rrjedhëse.


24. KOSTO E MALLRAVE TË SHITURA

Kosto e mallrave të shitur për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Kosto e mallrave të shitur	1,339,065,274	1,463,433,693
Zbritje financiare për furnitorë	(579,637)	(2,409,384)
TOTALI	1,338,485,637	1,461,024,310

Zbritjet financiare për furnitorë përfaqësojnë zbritjet e përftuara nga furnitorët për blerjen e mallrave për rishitje. Kosto e mallrave të shitura gjatë vitit përlogaritet bazuar në gjendjen e inventarit në fillim të periudhës, lëvizjeve të inventarit për rishitje dhe gjendjes në fund të vitit ushtrimor. Detajimet mbi qarkullimin e inventarit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Inventari në fillim të periudhës	1,308,430,555	1,360,794,268
Blerje mallra për rishitje	1,354,763,809	1,411,069,981
Gjendja e Inventarit në fund të periudhës	(1,324,708,727)	(1,308,430,555)
TOTALI	1,338,485,637	1,461,024,310



MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

25. SHPENZIME TË TJERA SHFRYTËZIMI

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime ndërmjetësimi, konsulencë, studim tregu	272,307,466	314,779,796
Transferime udhëtim e dieta	42,826,158	64,887,793
Publicitet dhe reklama	54,555,590	64,339,543
Vlera kontabël e AAM të shitura	3,522,883	43,316,358
Shpenzime transporti	20,981,692	18,932,501
Mirëmbajtje dhe riparime	26,025,291	18,830,297
Blerje energji elektrike	18,989,133	14,598,457
Qira	8,550,122	9,231,552
Shërbime bankare	9,923,102	9,162,889
Gjoha dhe dëmshpërblime	139,749	7,824,261
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	9,195,206	5,152,347
Blerje/shpenzime të tjera	7,466,360	6,832,597
Tatime dhe taksa vendore	6,454,578	6,400,418
Blerje karburant	4,332,440	4,791,956
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	4,166,494	4,161,029
Sigurime	4,076,007	3,876,841
Shërbime konsulence financiare dhe juridike	7,352,399	3,487,943
Shpenzime për koncesione, patentë	577,248	1,574,349
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	1,109,792	1,117,557
Shpenzime të tjera tatimore	2,057,921	925,807
Të tjera	6,054,344	29,620,239
TOTALI	510,663,978	633,844,530

Shpenzimet e shfrytëzimit kryen në mbështetje të aktivitetit tregtar dhe përbëhet kryesisht nga shërbimet e konsulencës dhe studimit të tregut nga kontraktorët e Shoqërisë, shpenzimet për konsulentët ligjorë, shpenzimet e publicitetit dhe transfertat, udhëtime e dieta. Shpenzimet të tjera shfrytëzimi përbëhet nga gjoha dhe dëmshpërblime, shpenzime tatimore të panjohura, subvencione të dhëna dhe shpenzime të tjera.

26. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet për personelin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Paga	98,557,781	132,887,558
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	16,546,671	22,357,424
TOTALI	115,104,452	155,244,982

Mesatarisht gjatë vitit 2020, Shoqëria ka pasur të punësuar 289 punonjës (2019: 315 punonjës). Sipas shënimit 18, Shoqëria nuk aplikon bonuse për shitjen e mallrave apo bonus për performancë.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

27. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE NETO

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitime nga kursi i kembimit	201,482,282	221,596,990
Humbje nga kursi i kembimit	(184,843,672)	(161,377,066)
Te Ardhurat Financiare	16,638,610	60,219,924
Te ardhura nga interesi dhe te tjera financiare	330	109,595
Shpenzime interesi	(57,639,281)	(59,145,059)
Shpenzimet Financiare	(57,638,951)	(59,035,463)
Te ardhurat Financiare Neto	(41,000,341)	1,184,460

Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit gjenerohen si rezultat i konvertimit të balancave dhe transaksioneve në valutë të huaj në monedhën vendase cdo muaj sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë. Të ardhurat nga interesi dhe të tjera financiare gjenerohen nga llogaritë rrjedhëse të Shoqërisë në monedhën vendase dhe të huaj, ndërsa shpenzimet e interesit përfaqësojnë interesin e pagueshëm sipas kushteve kontraktuale të kredisë afatgjatë, overdraftit.

28. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në normën 15% (2019:15 % i fitimit të tatueshëm dhe shpenzimi për tatim fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet dhe është përlllogaritur si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitimi para tatimit	78,738,092	64,816,141
Shpenzime të panjohura	10,889,885	14,231,826
Baza e llogaritjes së tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	89,627,977	79,047,969
Tatimi mbi fitimin @15%	13,444,196	11,857,195

Më poshtë paraqitet rakordimi i shpenzimit të tatimit fitimit me fitimin kontabël për llogaritjen e tatimit efektiv për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor			
	Norma e tatimit efektive	2020	Norma e tatimit efektive	2019
Fitimi para tatimit		78,738,090		64,816,143
Norma lokale teorike e tatimit:	15%	13,444,196	15%	11,857,195
Shpenzime të pazbritshme	2.5%	1,633,483	3%	2,134,774
Tatimi mbi fitimin	17.1%	15,077,680	18%	13,991,969

Një analizë më e detajuar e shpenzimeve të pazbritshme për Tatimin mbi Fitimin, në 26 material 26 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, paraqitet si më poshtë:

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

28. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Blerje karburant	14,652	9,080
Blerje/shpenzime të tjera	9,749	40,376
Gjoha dhe dëmtshpërblime	139,749	7,824,261
Provigjone	9,195,206	5,152,347
Mirëmbajtje dhe riparime	60,148	70,760
Publicitet dhe reklama	505,648	54,270
Shpenzime për koncesione, patentë	577,248	24,574
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	-	54,580
Të tjera	273,183	110,442
Të tjera tatimore të panjohura	114,303	351,256
Transferime udhëtim e dieta	-	230,007
Vlera kontabël e AAM të shitura	-	309,873
TOTALI	10,889,887	14,231,826

Sipas Ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", shpenzimet e pazbritshme nuk përfshihen në përllogaritjen e tatim fitimit për vitin ushtrimor. Peshën kryesore të shpenzimeve të pazbritshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 e zënë provigjonet për llogaritje e arkëtueshme.

29. PALËT E LIDHURA DHE TRANSAKSIONET ME TO

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrje; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Më poshtë paraqiten veprimet dhe tepricat përkatëse me palët e lidhura të Shoqërisë të cilat janë shoqëri në pronësi të aksionarit të shumicës.

29.1 Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, 31 dhjetor 2019, paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shitje mallra dhe/ose shërbime palëve të lidhura shoqërive në pronësi të aksionarit të shumicës	61,786,531	205,741,082
Totali	61,786,531	205,741,082

Shitje mallrash dhe/ose shërbimesh ndaj palëve të lidhura janë bërë me cmimet që Shoqëria zbaton me palë të treta duke bërë zbritje në varësi të volumeve dhe produkteve. Blerjet janë bërë me cmimet e tregut të zbritura këto për të reflektuar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve si dhe marrëdhënien e biznesit mes palëve.

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

29. PALËT E LIDHURA DHE TRANSAKSIONET ME TO (VAZHDIM)

29.1 Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 (vazhdim)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Blerje mallra dhe/ose Shërbime palëve të lidhura	40,656,331	47,367,821
Totali	40,656,331	47,367,821

Shoqëria është e angazhuar kryesisht në blerjen e shërbimeve nga palët e lidhura, si shërbimin e transportit, shërbimi e agentit doganor, shërbimin e sigurisë fizike e shërbime të tjera në mbështetje të aktivitetit të biznesit.

29.2 Teprricat e transaksioneve me palët e lidhura

Teprricat debitore dhe kreditore të palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

Të drejtat tregtare ndaj palëve të lidhura	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
<u>Shoqëri ne pronesi te aksionarit te vetem</u>	<u>43,248,073</u>	<u>114,104,690</u>
TOTALI	43,248,073	114,104,690

Detyrime tregtare ndaj palëve të lidhura	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
<u>Shoqëri ne pronesi te aksionarit te vetem</u>	<u>421,471,921</u>	<u>467,528,307</u>
TOTALI	421,471,921	467,528,307

Huamarrje të marra nga palët e lidhura	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
<u>Shoqëri ne pronesi te aksionarit te vetem</u>	<u>910,252,109</u>	<u>1,008,810,468</u>
TOTALI	910,252,109	1,008,810,468

Huadhënie ndaj palët e lidhura	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
<u>Shoqëri ne pronesi te aksionarit te vetem</u>	<u>8,143,367</u>	<u>7,718,500</u>
TOTALI	8,143,367	7,718,500

Balancat e papaguara në fund të vitit janë të pasiguruar dhe pa interes si dhe shlyerjet ndodhin në mjete monetare.

30. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Aktivitetet e kryera nga Shoqëria e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare, që përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në rrezikun e kreditit, rrezikun nga ndryshimi i kurseve të këmbimit dhe normave të interesit. Manaxhimi i rrezikut të Shoqërisë synon nëpërmjet identifikimit të burimeve në dispozicion, matjes së tyre dhe planifikimit, minimizimin e efekteve potenciale negative mbi performancën e biznesit të Shoqërisë. Ky proces kryhet nga Drejtimi i Shoqërisë bazuar në politikat dhe procedurat përkatëse të miratuara për rrezikun e likuiditetit, pozicionet neto valutore, rrezikun e kreditimit, rrezikun e kurseve të këmbimit dhe rrezikun e normës së interesit.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:

- rreziku i kreditit,
- rreziku i likuiditetit,
- rreziku i tregut.

MEGATEK sh.a.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

30. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektive të shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të shoqërisë.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e duhura të rrezikut, dhe për të monitoruar rrezikun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standarteve e procedurave të menaxhimit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre. Instrumentat kryesorë financiarë të shoqërisë përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentet me to, të arkëtueshmet, të pagueshmet, dhe të tjera të pagueshme.

30.1 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i drejtimit të rrezikut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin.

Rreziku i tregut përbëhet nga rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i tregut dhe ndryshimi në çmimet e kapitalit. Analizat e mëposhtme janë përgatitur bazuar në detyrimet neto, në raportin e përqindjes së interesit nga fiks në të luhatshëm dhe në pjesën e investimeve në monedhë të huaj në instrumenta financiar. Menaxhimi është përgjegjës në kontrollin e huave me përqindje interesi fikse dhe huave me përqindje interesi të luhatshëm.

i) Rreziku i kurseve të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit lidhur me luhatje të mundshme në normat e këmbimit përsa i përket transaksioneve të saj në monedhë të huaj. Shoqëria ka teprica në Euro dhe USD kundrejt kreditorëve dhe furnitorëve, të cilat e ekspozojnë njësinë kundrejt rrezikut të monedhës së huaj. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicionet neto të përshtatshme në çdo monedhë, në përputhje me aktivitetet e përditshme me këto monedha.

Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës

Ekspozimi i Shoqërisë kundrejt rrezikut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:

30. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Më 31 Dhjetor 2020	Totali	EUR	USD	LEK
Aktive Financiare				
Llogari të arkëtueshme	81,226,538	-	-	81,226,538
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	228,415,136	34,378	176,494	206,364,900
Aktive të tjera	47,601,357	32,729	-	43,550,499
Totali	357,243,029	67,107	176,494	331,141,937
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme	1,564,191,351	4,412,804	1,952,102	821,477,542
Hua nga palët e lidhura	910,252,109	-	-	910,252,109
Hua afatgjata	436,722,891	3,530,500	-	-
Totali	2,911,166,351	7,943,304	1,952,102	1,731,729,651
Pozicioni neto	(2,553,923,320)	(7,876,197)	(1,775,608)	(1,400,587,715)

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

30. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

30.1 Rreziku i tregut (vazhdim)

Pozicioni neto valutor më 31 dhjetor 2020 për totalin e tepricave të aktiveve dhe detyrimeve financiare, është negative për monedhën Lek dhe Euro, ku dominante është pozicioni valutor neto në Euro, kjo e ndikuar nga kredia afatgjatë dhe overdraftet e Shoqërisë të cilat janë të emërtuara në Euro.

Për shkak se aktiviteti tregtar kryhet në Lek, parashikohet që ky pozicion valutor të vijojë deri në vitin e ardhshëm, nëse huatë nga palët e lidhura nuk do të shlyhen në të ardhmen e parashikueshme.

Ekspozimi i Shoqërisë kundrejt rrezikut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

Më 31 Dhjetor 2019	Totali	EUR	USD	LEK
Aktive Financiare				
Llogari të arkëtueshme	160,149,527	-	-	160,149,527
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	108,627,264	263,022	128,087	62,683,673
Aktive të tjera	93,414,349	50,082	-	87,315,849
Totali	362,191,141	313,104	128,087	310,149,050
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme	1,370,819,672	4,288,851	(170,074)	867,043,098
Hua nga palët e lidhura	1,008,810,468	-	-	1,008,810,468
Hua afatgjata	565,096,480	4,640,687	-	-
Totali	2,944,726,620	8,929,538	(170,074)	1,875,853,566
Pozicioni neto	(2,582,535,479)	(8,616,434)	298,161	(1,565,704,516)

Pozicioni neto valutor më 31 dhjetor 2019 për totalin e tepricave të aktiveve dhe detyrimeve financiare, është negative për monedhën Lek dhe Euro. Pozicioni neto valutor është i ndikuar nga huatë nga palët e lidhura të cilat janë kryesisht në Lek dhe kreditimi nga bankat të emërtuara në Euro. Për shkak se aktiviteti tregtar kryhet në Lek, parashikohet që ky pozicion valutor të vijojë deri në vitin e ardhshëm, nëse huatë nga palët e lidhura nuk do të shlyhen në të ardhmen e parashikueshme.

Kurset mesatare të këmbimit për monedhën Euro dhe USD për vitin e mbyllur më 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	Kursi mesatar i këmbimit		Kursi në datën raportuese	
	2019	2019	2020	2019
EURO/LEKË	123.77	123.00	123.7	121.77
USD/LEKË	108.53	109.85	100.84	108.64

Analiza e ndjeshmërisë

Në menaxhimin e rrezikut të kursit të këmbimit shoqëria ka për qëllim të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e shoqërisë. Megjithatë, në periudha afatgjatë, ndryshimet e përhershme në normat e kurseve të këmbimit mund të kenë ndikim në fitim. Një analizë e ndikimit të vlerësuar të ndryshimeve në përqindjen e luhatjeve të vlerës së Lekut ndaj monedhave të huaja është paraqitur më poshtë.

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Monedha e huaj zhvlerësohet me 10%	115,084,359	141,620,994
Monedha e huaj zhvlerësohet me 10%	(115,084,359)	(141,620,994)

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

30. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

30.1 Rreziku i tregut (vazhdim)

Me një rritje prej 10% të kursit të këmbimit në datën e raportimit të Eur-s ndaj LEK-ut, dhe USD ndaj LEK-ut ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, do të shkaktonte një rritje prej 115,084,359 Lekë (31 dhjetor 2019: 141,620,994 Lekë) për shkak të ekspozimit ndaj letrave me vlerë dhe gjendjeve të llogarive afatshkurtra të emëruara në EURO, USD. Respektivisht, ndikimi në aktivet neto do të ishte i njëjtë.

Me një ulje prej 10 përqind të kursit të këmbimit në datën e raportimit të Euro-s ndaj Lekut, dhe USD ndaj Lekut ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar dhe aktivet neto të Shoqërisë do të ishte e njëjtë, por në drejtim të kundërt me ndikimin e rritjes të përshkruar më sipër.

ii) Rreziku i normave të interesit

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 Shoqëria ka detyrime interes-mbajtëse si kreditë dhe overdraftet e përftuara nga bankat e nivelit të dytë. Shoqëria përcakton se detyrimet e lidhura me huatë nga institucionet financiare janë të përcaktuara nga kushtet kontraktuale me norma interesi fikse, ndaj shpenzimet e interesit dhe flukset monetare janë të parashikuara dhe nuk ndikohen nga lëvizjet e normave të interesit në treg dhe më specifikisht nga normat ndërbankare.

30.2 Rreziku i likuiditetit

Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke mbajtur një nivel të mjaftueshëm rezervash monetare, limitesh bankare për kredi dhe ëta financiare të tjerë, duke monitoruar vazhdimisht dhe flukset aktuale të parasë si dhe duke përputhur maturimin e aseteve dhe detyrimeve të saj financiare.

Qëllimi i shoqërisë në menaxhimin e likuiditetit është që të sigurojë, aq sa është e mundur, se ajo gjithmonë do të ketë likuiditetin e mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve në kohë, si në kushtet normale ashtu edhe në ato të vështira, pa patur humbje të papranueshme apo pa rrezikuar dëmtimin e reputacionit të shoqërisë. Shoqëria ekspozimet kryesore në aktive dhe pasive i ka ndaj shoqërive të grupit dhe memes për të cilat pret të zbatojë kushte të përcaktuara por nuk do kërkesa rigoroze për përmbushjen e tyre në rast të problemeve me likuiditetin.

Më poshtë paraqiten marrëdhëniet kontraktuale, maturiteti i mbetur i aktiveve financiare dhe detyrimet duke përfshirë pagesat e interesit deri më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.



MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

30. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

30.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2020	Totali	1-12 Muaj	Më shumë se 1 vit
Aktive financiare			
Llogari të arkëtueshme	81,226,538	81,226,538	-
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	228,415,136	228,415,136	-
Aktive të tjera	47,601,357	47,601,357	-
Totali	357,243,031	357,243,031	-
Detyrime financiare			
Llogari të pagueshme	1,564,191,351	1,564,191,351	-
Huamarrje bankare	1,637,218,392	1,200,495,502	436,722,891
Totali	3,201,409,744	2,764,686,853	436,722,891
Pozicioni neto i likuiditetit	(2,844,166,714)	(2,407,443,823)	436,722,891

Më 31 dhjetor 2019	Totali	1-12 muaj	Më shumë se 1 vit
Aktive financiare			
Llogari të arkëtueshme	160,149,527	128,161,431	31,988,096
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	108,627,264	108,627,264	-
Huadhënie ndaj palëve të lidhura	6,098,500	6,098,500	-
Aktive të tjera	93,414,349	93,414,349	-
Totali	368,289,640	336,301,544	31,988,096
Detyrime financiare			
Llogari të pagueshme	1,370,819,672	1,370,819,672	-
Hua nga palët e lidhura	1,008,810,468	-	1,008,810,468
Hua bankare	1,657,882,337	1,092,785,857	565,096,480

Pozicioni neto i likuiditetit është negativ më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 si pasojë e burimeve të financimit përfshirë huatë nga palët e lidhura dhe institucionet financiare për një periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë. Shoqëria merr në konsideratë dhe flukset monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit për të vlerësuar aftësinë e saj për të ruajtur likuiditetin e nevojshëm. Sipas të dhënave nga pasqyra e flukseve monetare, flukset nga aktiviteti operativ janë pozitive ndërsa flukset e lira monetare gjithashtu tejkalojnë shpenzimet kapitale të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

30.3 Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditit është rreziku që palët e treta dhe të lidhura me Shoqërinë të mos përmbushin detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet kontraktuale kundrejt investimit në një entitet financiar ose llogarie të arkëtueshme, duke e shtyrë atë drejt humbjeve financiare, rrjedhimisht duke ndikuar në performancën dhe pozicionin financiar.

Rreziku i kreditit menaxhohet nga Shoqëria duke bërë vlerësime të palëve me të cilat hyn në marrëdhënie kontraktuale dhe monitorimit të vazhdueshëm të vjetërsisë së balancave dhe indikatorëve për zhvlerësim. Ekspozimi maksimal i rrezikut të kreditimit në datën e raportimit është vlera e mbartur e çdo klase të aktivitetit financiar.

Shoqëria është kryesisht e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë lidhur me llogaritë e arkëtueshme tregtare me palët e treta dhe palët e lidhura, vlerësimi i të cilave mund të ndikojë në pozicionin apo performancën e Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Ndërsa llogaritë e pagueshme të tjera pretendohen të shlyhen brenda 12 muajve nga data e raportimit financiar. Mjetet monetare dhe ekuivalentët që përbëjnë një peshë të rëndësishme në pozicionin financiar të Shoqërisë janë likuide brenda një periudhe afatshkurtër.

Llogaritë e arkëtueshme të cilat përbëjnë aktivet më të rëndësishme financiare janë detajuar si më poshtë në bazë të vjetërsisë së tyre:

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

30. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

30.3 Rreziku i kreditimit (vazhdim)

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Më pak se 1 muaj	7,123,422	9,577,182
1 deri në 3 muaj	10,927,780	5,130,314
3 deri në 6 muaj	14,388,038	3,356,594
6 deri në 12 muaj	50,585,348	118,068,760
Mbi 12 muaj	18,992,521	35,612,044
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(20,790,573)	(11,595,367)
TOTALI	81,226,536	160,149,527

31. RAPORTIMI I VLERËS SË DREJTË

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përcaktohet si vlera në të cilin instrumenti mund të shkëmbehet lehtësisht midis palëve të rena dakort në një transaksion, në ditën e matjes duke iu referuar kushteve aktuale të tregut (çmimi i shitjes në ditën e matjes nga perspektiva e palës që zotëron aktivin apo që mbart detyrimin). Kur një çmim nuk është i identifikueshem në treg, Shoqëria mat vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të tjera të identifikueshme në treg dhe minimizojnë të dhenat e paidentifikueshme. Këto metoda u përdorën për të vlerësuar vlerat e drejta si më poshtë:

- Para dhe depozita afatshkurtra, të drejta të tregtueshme, të drejta të pagueshme dhe detyrime të tjera afatshkurtra vlerësohen me vlerat e mbartura si pasojë e maturitetit të shkurtër së këtyre instrumentave.
- Hua dhe detyrime interes-mbajtëse me normë të ndryshueshme, përcaktohen sipas normave të interesit të specifikuar në marrëveshjet e huasë. Kështu që më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 vlera e mbartur e tyre vlerësohet të jetë e njëjtë me vlerën e drejtë të huave të ngjashme me karakteristika të ngjashme në treg.

32. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj përfshihet në çështje gjyqësore të ndryshme si dhe pretendime nga palët e treta të cilat janë subjekt i gjykimit të manaxhimit të Shoqërisë nëse mund të rezultojnë në fluskë monetare dalëse. Gjatë vitit 2020 Shoqëria është ende në proces si paditëse në çështjen gjyqësore ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për anulimin e gjobave të vendosura për taksat doganore për mallrat e zhdoganuara në vitin ushtrimor 2018. Çështja gjyqësore është ende në process apelimi. Shoqëria gjykon dhe vlerëson se nuk do ketë humbje nga këto çështje gjyqësore dhe si rrjedhim nuk janë njohur provigjone në këto pasqyra financiare.

33. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT DHE VIJIMËSIA

a. Covid-19

Më 24 mars 2020, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 243, në Shqipëri u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore, si pasojë e përhapjes së virusit COVID19 dhe klasifikimit të tij si pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë më 12 mars 2020. Banka ka vlerësuar ndikimin e mëtejshëm të zhvillimeve dhe masave të ndërmarra për situatën epidemiologjike pas përfundimit të periudhës raportuese dhe nuk i vlerëson si ngjarje të cilat kërkojnë korigjim ose shpalosje shtesë në pasqyrat financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

Në ditën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, masat kufizuese të aktivitetit ekonomik e shoqëror vijnë të jenë të aplikueshme. Efektet e pritura negative për Shoqërinë mund të lidhen vetëm me përkeqësimin e mundshëm të cilësisë së portofolit të kredisë, për ata klientë ose sektorë të ekonomisë, që janë prekur më së shumti nga efektet e pandemisë.

Faktorët ndikues janë të ndryshëm dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin duke përfshirë kohëzgjatjen e periudhës të kufizimit të veprimtarisë, ekspozimin ndaj tregtisë së jashtme, efektet në zinxhirin prodhues-furnizues-klient, nivelin e papunësisë dhe konsumin. Faktorë të shumtë dhe korrelacioni midis tyre e bëjnë më të vështirë llogaritjen e

MEGATEK sh.a.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(të gjitha shumat janë në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

33. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT DHE VIJIMËSIA (VAZHDIM)

a. Covid-19 (vazhdim)

besueshme të çdo efekti negativ financiar të ardhshëm, veçanërisht në kushtet kur ndikimi shtrihet globalisht dhe për një numër të madh sektorësh.

Strukturat e menaxhimit të Shoqërisë kanë ndërmarrë një seri masash për të mbështetur klientët e saj në trajtimin e situatës së pandemisë. Angazhimi kryesor ka qenë të sigurojë vazhdimësinë e shërbimeve Shoqërisë edhe në kushte të kufizimit të lëvizjeve. Shoqëria do të vazhdojë operacionet, duke siguruar shëndetin e stafit dhe klientëve të Shoqërisë.

Manaxhimi i Shoqërisë nuk është në dijeni për ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit me përjashtim të rasteve të paraqitura në shënimin 29.a dhe 29.b që do të kërkojë rregullime ose shpalosje shtesë në këto Pasqyra Financiare të veçanta.

